

VENDIM
Nr. 731, datë 27.11.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR SIGURINË E PERSONELIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Miratimin e rregullore “Për sigurinë e personelit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Vendimi nr. 188, datë 4.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, shfuqizohet.
- Ngarkohen ministrinë, institucionet shtetërore, Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe operatorët ekonomikë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR SIGURINË E PERSONELIT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i rregullore

Objekti i kësaj rregulloreje është:

- përcaktimi i rregullave për zhvillimin e procedurave të verifikimit të sigurisë ndaj individëve, që njohin, prodhojnë, ruajnë, administrojnë, transportojnë dhe transmetojnë informacion të klasifikuar, gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare, zbatimit të një kontrate në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, dhe në përmbushje të çdo veprimtarie në kuadrin e respektimit të parimit “nevojë për njohje”;
- përcaktimi i rregullave, i të drejtave e detyrimeve, mbi bazën e të cilave veprohet për lëshimin, refuzimin, pezullimin e përkohshëm, ndërprerjen e procedurave ose heqjen e “Certifikatës së sigurisë së personelit”, për edukimin e sigurisë, inspektimet dhe të drejtën e ankimit të individëve.

Neni 2
Fusha e veprimit

- Rregullat për sigurinë e personelit zbatohen nga ministrinë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë të interesuar për të qenë palë në një kontratë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar.
- Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në të njëjtën mënyrë ndaj të gjithë individëve, që u nënshtrohen procedurave të verifikimit të sigurisë për t’u pajisur me “Certifikatën e sigurisë së personelit”, në kuadrin e respektimit të parimit “nevojë për njohje”.

Neni 3 Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet verifikues”, Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH), Agjencia e Inteligjencës dhe e Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në përbërje të të cilave janë ngritur njësitë strukturore të specializuara për kryerjen e verifikimeve të sigurisë ndaj individëve, që do pajisen me “Certifikatën e sigurisë së personelit”.

2. “Brifimi/debrifimi i sigurisë”, tërësi instruksionesh dhe udhëzimesh sigurie, lidhur me procedurat e sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe përgjegjësitë individuale për shkeljet e rregullave të sigurisë, të cilave u nënshtrohen individët, që, për shkak të detyrës, kanë apo mund të kenë qasje në informacionin e klasifikuar.

3. “Certifikata e sigurisë së personelit (CSP)”, dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton nga pikëpamja e sigurisë se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

4. “Dyshime të arsyeshme”, përfshijnë një konkluzion përfundimtar, i cili mbështetet në analiza dhe vlerësime të argumentuara për informacione kryesisht indirekte, të përfutuara nga burime të besueshme dhe me akses, në bazë të të cilave krijohet bindja për ekzistencën e një fakti apo të një ngjarjeje që paraqet interes.

5. “Lidhje influencuese”, një lidhje e ngushtë, e cila evidentohet për shkak të aftësisë dhe të mundësisë që ka individ i për të ndikuar në ndryshimin thelbësor të sjelljeve, veprimeve dhe qëndrimeve të kërkuesit, që do të ketë akses tek informacioni i klasifikuar.

6. “Oficeri i sigurisë/struktura e sigurisë”, punonjësi përgjegjës ose njësi strukturore e ngarkuar nga titullari i institucionit shtetëror apo operatorit ekonomik të interesuar për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave për sigurinë e personelit dhe të disiplinave të tjera të informacionit të klasifikuar.

7. “Pyetësi i sigurisë së personelit”, formulari i modeluar nga AKSIK-u, që plotëson çdo individ që kërkon të njihet me informacion të klasifikuar dhe mbi bazën e të cilit kryhet verifikimi i sigurisë, si dhe vlerësohen të dhënat për të lëshuar ose jo “Certifikatën e sigurisë së personelit”.

8. “Rrezik i papranueshëm sigurie” konsiderohen rrethanat e përshkruara në ligjin nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, dhe në këtë rregullore, në bazë të të cilave AKSIK-u refuzon pajisjen me CSP ose vlerëson se duhet të ndër marrë masën e heqjes, ose të pezullimit të përkohshëm të saj.

9. “Rrethana të urgjencës së jashtëzakonshme”, kushtet e pamundësisë objektive për të ndjekur procedurat normale të pajisjes me CSP, për shkak të një rrethane specifike në kuadrin e ushtrimit të detyrave zyrtare apo të pjesëmarrjes në një aktivitet të paparashikuar ndërkombëtar, të zgjatjes së afateve të misionëve ushtarake në vende të ndryshme etj.

10. “Të dhëna të vërtetuara” përfshijnë një ose më shumë informacione për një fakt apo ngjarje të përfutur nga dy a më shumë burime të besueshme apo dokumente autentike.

11. “Verifikimi i sigurisë”, tërësia e masave dhe e procedurave të aplikuara ndaj një individ, mbi bazën e të cilave do të vlerësohet lëshimi, refuzimi, pezullimi i përkohshëm, ndërprerja e procedurave ose heqja e “Certifikatës së sigurisë së personelit”.

Neni 4 Parimet e verifikimit të sigurisë

Autoritetet verifikuese dhe çdo strukturë tjetër shtetërore, që përfshihet në procedurat e verifikimit të sigurisë, ka për detyrë që:

- a) të respektojë parimin e ligjshmërisë, të objektivitetit, të balancimit të interesave dhe të paanësisë;
- b) të angazhojnë punonjës me përvojë në kryerjen e procedurave të verifikimit;
- c) të kryejnë verifikimin e sigurisë, sipas kriterëve të përcaktuara të legjislacionit në fuqi;
- ç) të ruajë dinjitetin e individit që verifikohet;
- d) të respektojë afatet kohore të verifikimit të sigurisë.

Neni 5

Përgjegjësitë e autoriteteve verifikuese dhe të institucioneve të tjera shtetërore

1. AKSIK-u ka të drejtë të kërkojë informacion nga autoritetet verifikuese dhe institucionet shtetërore, që marrin pjesë në procesin e verifikimit lidhur me procedurat e zbatuara dhe afatet, të dhënat dhe dokumentacionin provues lidhur me verifikimin e rrezikut të papranueshëm të sigurisë për individët, që kanë paraqitur kërkesë ose janë të pajisur me CSP.

2. Çdo autoritet verifikues, institucion apo strukturë shtetërore, që merr kërkesën e paraqitur nga AKSIK-u për të kryer verifikimet e sigurisë, ka detyrimin e kthimit të përgjigjes me shkrim së bashku me informacionin e kërkuar. Përgjigja me shkrim duhet të jetë e plotë dhe e analizuar.

Autoriteti verifikues në përgjigjen me shkrim bën vlerësimin e sigurisë për individin, që ka kryer verifikime sigurie, shoqëruar me rekomandimin, nëse për të njëjtin ekziston ose jo rreziku i papranueshëm i sigurisë për pajisjen me CSP.

3. AKSIK-u dhe çdo strukturë shtetërore që merr pjesë në kryerjen e procedurave të verifikimit të sigurisë për pajisjen e një individi me CSP janë përgjegjëse për ruajtjen e të dhënave personale, të “sekretit shtetëror” dhe administrimin e dokumentacionit të grumbulluar, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Listat e funksioneve për njohjen e informacionit të klasifikuar

1. Ministrinë dhe institucionet shtetërore, të cilat, për shkak të veprimtarisë që kryejnë, prodhojnë informacion të klasifikuar ose, gjatë bashkëpunimit me institucione të tjera, e përftojnë këtë kategori informacioni, kanë për detyrë të miratojnë dhe të dërgojnë me shkrim në AKSIK listën e funksioneve organike, që, për shkak të detyrave zyrtare, mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar:

a) të prodhuar nga vetë institucioni dhe/ose të përftuar në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe dy ose shumëpalësh me shtete e organizata ndërkombëtare;

b) të NATO-s;

c) të Bashkimit Evropian.

2. Kategoritë e funksioneve, që mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar, referuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, miratohen me urdhër të titullarit të institucionit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

Në çdo rast, përpara miratimit, lista me kategoritë e funksioneve të parashikuara, duhet të konsultohet me AKSIK-në.

3. Në rastet kur AKSIK-u konstaton se lista e funksioneve organike, që, për shkak të detyrave zyrtare, mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar, është hartuar në shkelje të parimit “nevojë për njohje”, atëherë i rekomandon titullarit të institucionit marrjen e masave korrigjuese dhe rishikimin e saj brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike.

4. Lista e funksioneve organike, që, për shkak të detyrave zyrtare, mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar, rishikohet:

a) periodikisht, në përputhje me nevojat e veprimtarisë së institucionit dhe të rekomandimeve të AKSIK-ut;

b) kur ka ndryshime të strukturës organike të institucionit.

5. Dërgimi në AKSIK i listës së funksioneve organike kryhet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e miratimit.

KREU II PROCEDURA E KËRKESËS DHE E VERIFIKIMIT TË SIGURISË

Neni 7

Mënyrat e paraqitjes së kërkesës për t'u pajisur me CSP

1. Çdo individ, që ka zotësi të plotë për të vepruar dhe është në kushtet e zbatimit të parimit “nevojë për njohje”, mund të pajiset me CSP të vlefshme, kur kërkesa dhe dokumentacioni përkatës i adresohet AKSIK-ut nëpërmjet mënyrave, si më poshtë vijon:

a) Me kërkesë të titullarëve të ministrive dhe të institucioneve shtetërore për punonjësit, stafet e tyre dhe individë të tjerë, të kontraktuarit ose kategoritë e individëve të parashikuar për të marrë pjesë në një prokurim në fushën e mbrojtjes e të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar;

b) Me kërkesë të autoritetit homolog të një vendi tjetër, anëtar i NATO-s, i Bashkimit Evropian ose i vendit me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar dhe është në fuqi marrëveshja e përbashkët për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar;

c) Me kërkesë të autoritetit kompetent të sigurisë së NATO-s, të një strukture të saj apo të Bashkimit Evropian;

ç) Me kërkesë të drejtpërdrejtë të administratorit të një operatori ekonomik vendas, në kuadrin e procedurave për pajisje me CSI e CSP, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Dokumentacioni bazë i kërkesës për pajisje me CSP

1. Dokumentacioni i kërkesës për pajisje me CSP, që i adresohet AKSIK-ut, përbëhet nga:

a) kërkesa e nënshkruar nga autoriteti përkatës, sipas përcaktimeve në shkronjat: “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 7, të kësaj rregulloreje;

b) pyetësori i sigurisë së kërkuesit, shoqëruar me fotografinë e tij;

c) deklaratat për ruajtjen e informacionit të klasifikuar, nënshkruar nga kërkuesi;

ç) deklaratat për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e informacionit dhe kryerjen e verifikimeve të sigurisë, nënshkruar nga kërkuesi;

d) fotokopje e letërnjoftimit ose e pasaportës së kërkuesit.

2. AKSIK-u harton dhe miraton modelet përkatëse të dokumenteve të parashikuara në shkronjat: “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni.

Neni 9

Verifikimi paraprak

1. Në rastet kur kërkesa për pajisje me CSP kryhet me kërkesë të subjekteve të parashikuara në shkronjat “a” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 7, të kësaj rregulloreje, titullari i ministrisë apo i institucionit shtetëror ose administratori i një operatori ekonomik vendas, marrin masa përmes oficerit të sigurisë/strukturës së sigurisë, apo oficerit të sigurisë industriale, për kryerjen e verifikimit paraprak të kërkuesit. Ky proces konsiston në verifikimin e:

a) certifikatës së gjendjes gjyqësore;

b) vërtetimit të gjykatës;

c) vërtetimit të prokurorisë;

ç) vërtetimit të zyrës së përmbarimit.

Dokumentet e kërkuara në shkronjat “b” dhe “c”, të kësaj pike, merren në institucionet, ku kërkuesi ka vendbanimin, referuar gjendjes civile.

2. Dokumentet e verifikimit paraprak mbahen nga oficeri i sigurisë/struktura e sigurisë apo oficeri i sigurisë industriale.

3. Në rastet kur kërkesa për pajisje me CSP është bërë nga subjektet e parashikuara në shkronjat “b” e “c”, të pikës 1, të nenit 7, të kësaj rregulloreje, atëherë kërkuesi duhet t’i dorëzojë në AKSIK të gjitha dokumentet e verifikimit paraprak të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, së bashku me dokumentacionin bazë të kërkesës së parashikuar në nenin 8, të kësaj rregulloreje.

Neni 10

Kushtet për fillimin e verifikimit të sigurisë

1. Procedurat për verifikimin e sigurisë së personelit shërbejnë për të përcaktuar nëse një individ, duke iu referuar besnikërisë, besueshmërisë dhe sigurisë së tij, mund të autorizohet për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar pa e rrezikuar sigurinë e këtij informacioni.

2. Verifikimi i sigurisë fillon vetëm pasi individ i kërkues ka pranuar dhe ka dhënë pëlqimin me shkrim që:

a) të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të sigurisë, sipas kërkesave të pyetësorit të sigurisë së personelit;

b) të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të sigurisë edhe pas pajisjes me CSP, në funksion të sqarimit të dyshimeve të bazuara në ndryshimin e gjendjes së pasqyruar në pyetësorin e sigurisë së personelit, për aq kohë sa ekzistojnë kushtet e nevojës për njohje të informacionit të klasifikuar.

Neni 11

Shqyrtimi fillestar

1. Pas paraqitjes së kërkesës për t’u pajisur me CSP, AKSIK-u shqyrton, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, kërkesën e dokumentacionin bashkëlidhur/bashkëngjitur dhe, kur e gjen të plotë e të bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi, fillon procedurën e verifikimit të sigurisë.

2. Në rastet kur dokumentacioni i kërkesës për t’u pajisur me CSP ka mangësi, AKSIK-u e kthen praktikën e paraqitur për të bërë plotësimet e kërkuara tek institucioni shtetëror ose operatori ekonomik i interesuar, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike pas afatit të shqyrtimit fillestar.

Neni 12

Kërkesat për vlerësimin e rrezikut të papranueshëm të sigurisë

1. AKSIK-u, autoritetet verifikuese dhe çdo strukturë tjetër shtetërore, që përfshihet në procedurat e verifikimit të sigurisë, duhet t’u përmbahen kriterëve themelore të vlerësimit të sigurisë të përcaktuara në nenin 30, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”.

2. AKSIK-u, autoritetet verifikuese dhe çdo strukturë tjetër shtetërore, që përfshihet në procedurat e verifikimit të sigurisë, duhet që gjatë këtij procesi:

a) të bëjnë verifikime të plota, duke iu përmbajtur identitetit apo identiteteve të kërkuesit dhe rrethit të personave, objekt verifikimi, statusit të shtetësisë aktuale dhe në të shkuarën;

b) të shfrytëzojnë të dhëna, dokumente zyrtare dhe rekorde, në funksion të verifikimit të sigurisë në nivel lokal, kombëtar e, sipas rastit, edhe në atë ndërkombëtar;

c) të qartësojnë statusin dhe pozicionin financiar të kërkuesit dhe të rrethit të personave objekt verifikimi, me qëllim verifikimi, nëse zotërohet ndonjë pasuri e pajustificuar apo mund të gjendet nën presion për shkak të nivelit të lartë të borxheve apo vështirësive serioze financiare;

ç) të konfirmojnë ose jo të dhënat e paraqitura nga kërkuesi për edukimin arsimor dhe historikun e punësimeve të tij, duke marrë në konsideratë referencat e punëve të mëparshme dhe raportet e punëdhënësve;

d) të qartësojnë motivet e qëndrimit jashtë vendit në çdo rast mbi 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë kalendarike;

dh) bazuar në informacione dhe dokumente autentike, sipas rastit, të vlerësojnë nëse për kërkuesin ekzistojnë rrethana, që ai mund të vihet nën presion apo të shantazhohet nga një forcë e huaj jomiqësore.

3. Vlerësimi përfundimtar për ekzistencën ose jo të rrezikut të papranueshëm të sigurisë kryhet nga AKSIK-u, mbështetur në rezultatet e verifikimeve të kryera dhe të përmbajtjes së informacioneve të përftuara nga autoritetet verifikuese e, sipas rastit, edhe autoriteteve homologe, si dhe çdo strukturë tjetër shtetërore e angazhuar në verifikimin e sigurisë të individit, që ka paraqitur kërkesë për pajisje me CSP.

Neni 13

Institucionet dhe autoritetet e përfshira për verifikimin e sigurisë

1. AKSIK-u ka të drejtë të kërkojë informacion dhe të bashkëpunojë, në funksion të verifikimit të sigurisë për çdo individ, që ka paraqitur kërkesë për t'u pajisur me CSP, me autoritetet verifikuese dhe institucionet e tjera shtetërore.

Në procedurat e verifikimit të sigurisë përfshihen:

a) autoritetet verifikuese: Shërbimi Informativ i Shtetit, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, Agjencia e Inteligjencës dhe e Sigurisë së Mbrojtjes;

b) institucione të tjera: Prokuroria e Përgjithshme, SPAK-u dhe strukturat e tjera të drejtësisë, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Policia e Shtetit, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Banka e Shqipërisë dhe çdo institucion tjetër, diktuar nga nevojat konkrete të verifikimit të sigurisë.

2. AKSIK-u ka të drejtë të kërkojë dhe të shkëmbejë informacion në funksion të verifikimit të sigurisë me autoritetet homologe të një vendi anëtar të NATO-s, Bashkimit Evropian ose të një vendi me të cilin është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi marrëveshja e përbashkët për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

3. Përcaktimi i institucioneve apo i autoriteteve, që do të përfshihen në verifikimin e sigurisë, bëhet rast pas rasti, referuar specifikave për çdo kërkues, që do t'i nënshtrohet verifikimit të sigurisë për pajisjen me CSP.

Neni 14

Detyrat e autoriteteve verifikuese

1. Autoritetet verifikuese kryejnë detyrat e parashikuara në nenin 15, të kësaj rregulloreje dhe, për çdo rast, kryejnë verifikimet e sigurisë, në përputhje me kërkesat e përgjithshme të vlerësimit të sigurisë, të parashikuara në nenin 12, të kësaj rregulloreje.

2. Autoritetet verifikuese, gjatë procesit të verifikimit të sigurisë për individët, që do të pajisen me CSP:

a) dërgojnë informacionin e kërkuar, duke ruajtur e garantuar mosekspozimin e burimeve të informacionit;

b) kërkojnë dhe, sipas rastit, shkëmbejnë informacion me institucione të tjera shtetërore;

c) kryejnë intervista sigurie;

ç) kryejnë vlerësimin e sigurisë dhe e adresojnë në AKSIK në formatin e bazuar në “të dhëna të vërtetuara” apo “dyshime të arsyeshme” dhe në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë rregullore.

Në çdo rast, vlerësimi i sigurisë përmban edhe rekomandimin e autoritetit verifikues, nëse individit që u është nënshtruar procedurave të verifikimit të sigurisë për pajisje me CSP përbën rrezik të papranueshëm ose jo për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

3. Në raste të veçanta apo në kuadër të verifikimeve shtesë, autoritetet verifikuese adresojnë në afate informacionin e kërkuar plotësisht.

4. Autoritetet verifikuese kryejnë në mënyrë të vazhdueshme vlerësim sigurie për individët, pasi ata janë pajisur me CSP.

Ky vlerësim sigurie bëhet për të evidentuar nëse ka ndryshime në sjelljet dhe në veprimet e individit, të cilat e bëjnë atë të cenueshëm nga pikëpamja e besnikërisë, besueshmërisë dhe sigurisë së tij, referuar kriterëve të përcaktuara në nenin 12, të kësaj rregulloreje.

5. Në rastet kur për një individ të pajisur me CSP të vlefshme përfitohet informacion, që pasqyron të dhëna të vërtetuara apo dyshime të arsyeshme, lidhur me ekzistencën e rrezikut të papranueshëm të sigurisë, AKSIK-u, në bashkëpunim me autoritetet verifikuese, mund të përcaktojë një plan veprimi me masa të përbashkëta, deri në qartësimin e plotë të dyshimeve të referuara.

6. Autoritetet verifikuese bashkëpunojnë ngushtësisht ndërmjet tyre, me AKSIK-në dhe, sipas rastit, edhe me institucionet e tjera shtetërore në funksion të verifikimit të sigurisë për individët, që kanë paraqitur kërkesë për t'u pajisur me CSP.

7. Mënyra e funksionimit të autoriteteve verifikuese për kryerjen e procedurave të verifikimit të sigurisë rregullohet me urdhër të miratuar nga titullari i institucionit, një kopje e të cilit i dërgohet AKSIK-ut jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendrike nga data e miratimit të këtij akti.

Neni 15

Shkëmbimi i drejtpërdrejtë i informacioneve ndërmjet autoriteteve verifikuese

1. Autoritetet verifikuese duhet të bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit të kërkuar në funksion të kryerjes së procedurave të verifikimit të sigurisë për pajisje me CSP për të gjithë individët, për të cilët ata janë të ngarkuar të kryejnë apo kanë kryer verifikime sigurie, referuar legjislacionit në fuqi, për shkak se janë të punësuar ose do të punësohen në strukturat e:

- a) Ministrisë së Mbrojtjes;
- b) Ministrisë së Brendshme;
- c) Shërbimit Informativ të Shtetit.

2. Në çdo rast, referuar pikës 1, të këtij neni, kërkesat dhe përgjigjet reciproke për verifikim sigurie të një autoriteti verifikues për autoritetin tjetër verifikues duhet të përmbajnë referencën ligjore, të dhëna të plota identifikuese për individin, objekt verifikimi sigurie, dhe informacionin e mjaftueshëm, shoqëruar me specifikimin nëse “të dhënat janë të vërtetuara” apo janë në “kuadrin e dyshimeve të arsyeshme”.

3. Në raste të veçanta dhe pas miratimit paraprak të titullarëve përkatës, një autoritetet verifikues ka të drejtë që të njohë në mënyrë të drejtpërdrejtë përmbajtjen e informacioneve apo të dokumenteve implikuese, që disponon autoriteti tjetër verifikues në adresë të individëve, për të cilët ata janë të ngarkuar të kryejnë apo kanë kryer verifikime sigurie për pajisjen me CSP. Në raste të tilla, duhet të ruhet e të garantohet mosekspozimi i burimeve të informacionit.

4. Autoriteti verifikues, pasi ka kryer në mënyrë të plotë verifikimin e sigurisë, duke shkëmbyer më parë informacion me autoritetet e tjera verifikuese dhe, sipas rastit, edhe me institucione të tjera shtetërore, adreson në AKSIK vlerësimin e sigurisë për individët, që do të pajisen me CSP.

Ky vlerësim sigurie përmban:

a) të dhëna të plota identifikuese të individit, ndaj të cilit janë aplikuar procedurat e verifikimit të sigurisë;

b) përmbledhje të strukturuar të informacionit, që ka rezultuar nga verifikimi i sigurisë, duke përfshirë korrespondencën ndërmjet autoriteteve verifikuese apo me institucionet e tjera shtetërore. Në këtë përmbledhje përfshihen edhe rezultatet e përfutuara nga kryerja e testit të Poligrafit, kur një procedurë e tillë është kryer nga autoriteti verifikues, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi;

c) specifikimin “të dhëna të vërtetuara” apo “dyshime të arsyeshme”, nëse për një individ është përfutur informacion implikues, referuar nenit 12, të kësaj rregulloreje;

ç) rekomandimin, nëse pajisja me CSP përbën rrezik të papranueshëm ose jo për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

Neni 16

Detyrat e AKSIK-ut

1. AKSIK-u bashkëpunon ngushtësisht me autoritetet verifikuese dhe mbikëqyr kryerjen prej tyre të procedurave, në funksion të verifikimit të sigurisë, për individët që kanë paraqitur kërkesë për t'u pajisur me CSP.

2. Gjatë veprimtarisë së saj, AKSIK-u ka për detyrë:

a) të inspektojë e të mbikëqyrë aspektet e procedurave të aplikuara prej tyre për verifikimin e sigurisë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;

b) të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion me autoritetet homologe për verifikimin e sigurisë, sipas kriterëve të përcaktuara;

c) të njihet në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm me përmbajtjen e informacionit implikues në adresë të individit, ndaj të cilit kryhet verifikimi i sigurisë;

ç) të iniciojë analiza të përbashkëta me autoritetet verifikuese për raste specifike, lidhur me ndjekjen e procedurave të verifikimit të sigurisë;

d) të ftojë, sipas përkatësisë, përfaqësues të autoriteteve verifikuese, që të marrin pjesë në intervista sigurie, që kryhen në AKSIK;

dh) të marrë masa për edukimin, vetëdijesimin dhe trajnimet e sigurisë të përfaqësuesve të autoriteteve verifikuese dhe të institucioneve të tjera shtetërore lidhur me aspektet e procedurave të verifikimit të sigurisë.

3. Në rastet kur verifikimi i sigurisë për një kërkues rezulton me ekzistencën e rrezikut të papranueshëm të sigurisë, AKSIK-u ka të drejtë t'i kërkojë autoritetit verifikues informacione sqaruese shtesë, si dhe të njihet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbajtjen e këtij informacioni, i cili ka shërbyer për të arritur në atë përfundim.

Pas kryerjes së këtyre procedurave, analizimit të rrethanave dhe përmbajtjes së informacionit të përfutur, AKSIK-u vijon me lëshimin, refuzimin, pezullimin e përkohshëm, ndërprerjen e procedurave apo heqjen e CSP-së.

Neni 17

Afatet dhe koha që mbulon verifikimi i sigurisë

1. Verifikimi i sigurisë mbulon një periudhë jo më pak se 10 (dhjetë) vitet e fundit të jetës së kërkuesit dhe të rrethit të personave që verifikohen, sipas rasteve të parashikuara në nenin 19, të kësaj rregulloreje.

2. Kur kjo periudhë është e pamjaftueshme, verifikimi shtrihet nga mosha 18 vjeç deri në moshën aktuale.

Neni 18

Afatet e kryerjes së verifikimeve të sigurisë

1. Afati i përgjithshëm i kryerjes së verifikimit të sigurisë nga AKSIK-u, duke përfshirë autoritetet verifikuese dhe institucionet e tjera shtetërore, është 120 (njëqind e njëzet) ditë kalendarike.

Afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit të sigurisë fillon vetëm pas paraqitjes së plotë të dokumentacionit në AKSIK.

2. Autoriteti verifikues dhe çdo strukturë tjetër shtetërore, që merr kërkesën e paraqitur nga AKSIK-u për të kryer verifikimin e sigurisë, ka detyrimin të kryejë procedurat përkatëse dhe të kthejë përgjigje me shkrim, duke dhënë informacionin e kërkuar, jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës.

Në vijim, AKSIK-u brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike, konkludon për lëshimin, refuzimin e CSP-së, ndërprerjen e procedurave apo kryerjen e verifikimeve shtesë dhe bashkëpunimin me autoritetet homologe të vendeve të tjera.

3. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikat 1 e 2, të këtij neni, për çdo rast tjetër, referuar rrethanave të parashikuara nga neni 15, i kësaj rregulloreje, autoritetet verifikuese kryejnë verifikimet e sigurisë brenda 75 (shtatëdhjetë e pesë) ditëve kalendarike dhe bëjnë adresimin në AKSIK të vlerësimit të sigurisë, shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar për vijimin e procedurave të mëtejshme.

Për këto raste, AKSIK-u, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike, konkludon për lëshimin, refuzimin e CSP-së, ndërprerjen e procedurave apo kryerjen e verifikimeve shtesë dhe bashkëpunimin me autoritetet homologe të vendeve të tjera.

4. Afatet e verifikimit të sigurisë mund të jenë më të gjata se koha e parashikuar kur:

a) verifikimet kushtëzohen nga kryerja e procedurave, në bashkëpunim me autoritetet homologe të vendeve të tjera;

b) kur titullari i AKSIK-ut udhëzon kryerjen e verifikimeve shtesë.

Neni 19

Rrethi i personave që verifikohen

1. Verifikimi i sigurisë përfshin:

a) vetëm personin kërkuar dhe lidhjet influencuese me interes, kur kërkohet njohja me informacionin e klasifikuar, të nivelit “konfidencial”;

b) personin kërkuar, fëmijët, bashkëshortin/bashkëshorten, bashkëjetuesin/bashkëjetuesen dhe lidhjet influencuese me interes, kur kërkohet njohja me informacionin e klasifikuar, të nivelit “sekret”;

c) personin kërkuar, fëmijët, bashkëshortin/bashkëshorten, bashkëjetuesin/bashkëjetuesen, prindërit, lidhjet influencuese me interes dhe personat e tjerë, që jetojnë së bashku në të njëjtën familje, kur kërkohet njohja me informacionin e klasifikuar, të nivelit “tepër sekret”.

2. Verifikimi i sigurisë i lidhjeve të ngushta familjare dhe atyre influencuese me interes, të përcaktuara në shkronjat: “a”, “b” e “c”, të pikës 1, të këtij neni, kryhet për të arritur në përfundimin nëse ekziston rreziku real që kërkuar të shantazhohet përmes këtyre lidhjeve, të cilat, në bazë të verifikimit të sigurisë, rezultojnë të përfshira në veprimtari:

a) spiunazhi;

b) terrorizmi;

c) krimi të organizuar.

Neni 20

Intervista e sigurisë

1. Autoritetet verifikuese kryejnë intervistën e sigurisë:

a) me individë, të cilët kanë paraqitur kërkesë për t'u pajisur me CSP dhe në drejtim të tyre janë ndërmarrë procedurat e verifikimit të sigurisë;

b) me individë të pajisur me CSP të vlefshme, pas kthimit të tyre nga udhëtimi/shërbimi nga vendet e vlerësuara me rrezik të veçantë sigurie;

c) me persona të tjerë të paanshëm, të cilët njohin të shkuarën dhe aktivitetet e personit, që është duke iu nënshtruar verifikimit të sigurisë.

2. AKSIK-u interviston individë, të cilët kanë paraqitur kërkesë për t'u pajisur me CSP, edhe persona të tjerë të paanshëm, të cilët njohin të shkuarën dhe aktivitetet e kërkuarit, kur:

a) individi kërkuar ka deklaruar ose rezulton se ka qenë subjekt i procedurave për azil politik, mban shtetësi të dytë/tretë apo ka pasur ose ka shtetësi tjetër;

b) gjatë procesit të verifikimit të sigurisë ose pas pajisjes me CSP është referuar informacion me përmbajtje implikuese apo informacion, i cili është i nevojshëm për t'u sqaruar në mënyrë direkte, pasi ka ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen e AKSIK-ut për lëshimin, refuzimin, pezullimin apo heqjen e CSP-së.

3. Individi që i nënshtrohet intervistës së sigurisë ka të drejtë që të ofrojë dokumente dhe informacione shtesë lidhur me aktivitetin e tij në mbështetje të verifikimit të sigurisë.

4. Drejtori i përgjithshëm i AKSIK-ut nxjerr udhëzim për kryerjen e intervistës së sigurisë në kuadrin e zbatimit të rregullave për sigurinë e personelit.

KREU III

LËSHIMI, REFUZIMI, HEQJA, PEZULLIMI I PËRKOHSHËM I CSP-së. RIPAJISJA, ANKIMIMI DHE RRETHANAT E JASHTËZAKONSHME

Neni 21

Parimet e lëshimit të CSP-së

1. AKSIK-u është institucioni i vetëm që lëshon CSP për shtetasit shqiptarë, në përputhje me nivelin dhe tipin e parashikuar në këtë rregullore.

2. Lëshimi i CSP-së nga AKSIK-u bëhet vetëm me qëllim për njohjen, ruajtjen, administrimin apo transferimin e informacionit të klasifikuar, bazuar në parimin "nevojë për njohje".

AKSIK-u bën ndërprerjen e menjëhershme të procedurave të verifikimit të sigurisë, kur konstaton se kërkesa për pajisjen e një individi me CSP nuk përputhet me parimin "nevojë për njohje".

3. Për individët e vendeve të tjera, CSP-ja lëshohet nga autoritetet e sigurisë kombëtare ose çdo autoritet kompetent sigurie i vendit, shtetësinë e të cilit mban individi.

4. Përpara se të lëshohet CSP-ja për një individ, i cili mban edhe shtetësinë e një vendi tjetër, apo i njëjti ka qëndruar më shumë se 6 (gjashtë) muaj për arsye të ndryshme jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, atëherë AKSIK-u bashkëpunon edhe me autoritetet homologe për kryerjen e verifikimeve përkatëse të sigurisë.

Ky bashkëpunim shtrihet vetëm me autoritetet homologe të vendeve anëtare të NATO-s, të Bashkimit Evropian ose të vendeve me të cilat vendi ynë ka nënshkruar dhe është në fuqi marrëveshja e përbashkët për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

Neni 22

Nivelet e CSP-së që lëshohet nga AKSIK-u

1. Nivelet e CSP-së që lëshohen nga AKSIK-u janë:

a) "konfidencial";

b) "sekret";

c) "tepër sekret".

2. Njohja me informacionin e klasifikuar kryhet në përputhje me nivelin e CSP-së. Zotëruesi i një CSP-je me nivel më të lartë ka të drejtë që, në kushtet e nevojës për njohje, të ketë akses tek informacione të klasifikuara të një kategorie më të ulët.

3. AKSIK-u lëshon CSP në nivel më të ulët se ai që është kërkuar, në rastet kur:

- a) konstatohet se një individ nuk është në kushtet e nevojës për njohje të informacionit të klasifikuar në nivelin e kërkuar;
- b) diktohet nga rezultatet e përfuara nga vlerësimi i sigurisë.

Neni 23

Tipet e CSP-së që lëshohet nga AKSIK-u

1. AKSIK-u lëshon CSP për njohjen, ruajtjen, administrimin apo transferimin e informacionit të klasifikuar:

- a) të prodhuar nga institucionet tona shtetërore ose/dhe të përfuara në kuadrin e bashkëpunimit dy- ose shumëpalësh me shtete dhe organizata të tjera ndërkombëtare;
- b) të NATO-s;
- c) të Bashkimit Evropian.

2. Modelet për tipat e CSP-së miratohen nga AKSIK-u.

3. CSP për njohjen, ruajtjen, administrimin apo transferimin e informacioneve të klasifikuara të NATO-s dhe të Bashkimit Evropian lëshohen në gjuhën angleze dhe në përputhje me standardet e kërkesat e këtyre organizatave.

Neni 24

Vlefshmëria e CSP-së

1. CSP e lëshuar nga niveli “konfidencial” e më lart ka një afat vlefshmërie deri në 5 (pesë) vjet.

2. Në rastet kur një individ, i cili zotëron një CSP të vlefshme, transferohet në një pozicion pune që, sipas listës së funksioneve organike të miratuar të institucionit të ri duhet të ketë CSP, atëherë AKSIK-u, pas kërkesës së arsyetuar me shkrim të institucionit të ri, bën konfirmimin e vlefshmërisë së CSP-së dhe modelimin e saj, në përputhje me të dhënat e reja të pozicionit të punës.

Neni 25

Ndryshimi i nivelit të CSP-së

1. Në rastet kur një individ, i cili zotëron një CSP të një niveli më të ulët, caktohet në një pozicion pune, i cili parashikon nevojën për mbajtjen e një CSP-je të një niveli më të lartë se ajo që disponon, AKSIK-u, pas kërkesës së paraqitur nga institucioni i interesuar, nis kryerjen e procedurave shitesë të verifikimit, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Lëshimi i CSP-së në nivelin e kërkuar kryhet pas kryerjes së verifikimeve të sigurisë dhe kur nuk ekzistojnë rrethana, që përbëjnë pengesa ligjore për lëshimin e CSP-së, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

3. Afati i vlefshmërisë së CSP-së me nivelin e ndryshuar është i njëjtë me afatin që ishte parashikuar në CSP-në e nivelit më të ulët.

4. Për individët që mbajnë një CSP të vlefshme, afati i së cilës përfundon brenda 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditëve kalendarike, nuk mund të paraqitet kërkesë për ndryshimin e saj në një nivel më të lartë se CSP-ja ekzistuese. Në këto raste zbatohen dispozitat e parashikuara në nenin 26, të kësaj rregulloreje.

Neni 26

Ripajisja me CSP

1. Ripajisja me CSP kryhet nga AKSIK-u, sipas procedurave të miratuara në këtë rregullore.
2. Procedura për ripajisjen me CSP fillon rishtazi me paraqitjen e kërkesës nga e para.
3. Kërkesa për ripajisje me CSP paraqitet në AKSIK-u jo më vonë se 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë kalendarike përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së CSP-së ekzistuese.
4. Pas kryerjes së procedurave të riverifikimit dhe kur nuk ekzistojnë rrethana që përbëjnë pengesa ligjore, AKSIK-u bën ripajisjen e kërkuarit me CSP, sipas kritereve të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 27

Refuzimi, heqja dhe pezullimi i përkohshëm i CSP-së

1. AKSIK-u ka të drejtë të marrë vendim për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP-së, në rastet kur nëpërmjet autoriteteve verifikuese ose/dhe strukturave shtetërore të përfshira në procesin e verifikimit është përfutur informacion, sipas të cilit vlerësohet se pajisja ose mbajtja e mëtejshme e CSP-së nga një individ i caktuar përbën rrezik të papranueshëm sigurie, referuar kritereve të parashikuara në nenin 12, të kësaj rregulloreje.
2. Njoftimi për vendimin e marrë nga AKSIK-u për refuzim, heqje ose pezullim të përkohshëm të CSP-së i komunikohet me shkrim titullarit të strukturës kërkuese, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga AKSIK-u.
- Kjo kërkesë i adresohet titullarit të AKSIK-ut brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP-së.
3. Titullari i AKSIK-ut e shqyrton kërkesën e paraqitur brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e pranimit të saj dhe njofton titullarin e strukturës kërkuese.
4. Në rastet e mospajtit me përgjigjen e titullarit të AKSIK-ut, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit, titullari i strukturës kërkuese ka të drejtë të paraqesë ankim me shkrim te Kryeministri.
5. Kryeministri, pas marrjes së ankimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, shprehet me akt të veçantë, i cili është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim nga AKSIK-u dhe struktura që ka bërë ankimin.

Neni 28

Kohëzgjatja e pezullimit

1. Vendimi për pezullimin e përkohshëm të CSP-së është i vlefshëm deri në momentin e shuarjes së rrethanave, që përbëjnë rrezik të papranueshëm sigurie ose deri në momentin kur CSP-së i ka përfunduar afati i vlefshmërisë.
2. Gjatë kohëzgjatjes së pezullimit të CSP-së, titullari i institucionit shtetëror dhe, sipas rastit, administratori i operatorit ekonomik kanë detyrim të marrin masat përkatëse për ndalimin e aksesit tek informacioni i klasifikuar për individin, të cilit i është pezulluar CSP-ja.

Neni 29

Afati i riparaqitjes së kërkesës në rastet e refuzimit apo të heqjes së CSP-së

1. Individët, të cilëve u është refuzuar ose hequr CSP-ja, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë përsëri, me kusht që të ketë kaluar një vit kalendarike nga data e shkresës njoftuese për heqjen ose refuzimin e CSP-së, adresuar titullarit të institucionit, ku bën pjesë kërkuesi.
2. Pas riparaqitjes së kërkesës, referuar rasteve të pikës 1, të këtij neni, ndiqen procedurat e verifikimit të sigurisë, në përputhje me kriteret e parashikuara në këtë rregullore.

Neni 30

Lëshimi i CSP-së në rrethana të urgjencës së jashtëzakonshme

1. Në kushtet e rrethanave të urgjencës së jashtëzakonshme, AKSIK-u ka të drejtë të lëshojë CSP-në deri dhe përfshirë nivelin “sekret” për një afat jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike, pa iu nënshtruar procedurave normale të verifikimit të sigurisë, për çdo individ, që është punonjës i një institucioni shtetëror, në rastet kur:

a) individi ndodhet në kushtet e ushtrimit të një detyre afatshkurtër zyrtare, për të cilën ka qenë e pamundur ndjekja e procedurave, sipas afateve kohore të parashikuara në këtë rregullore;

b) individi ka nevojë për pjesëmarrje në një aktivitet të paparashikuar kombëtar apo ndërkombëtar, për të cilin ka qenë e pamundur ndjekja e procedurave, sipas afateve kohore të parashikuara;

c) individi, i cili nuk ka qenë i pajisur me CSP, ndodhet në kushtet e zgjatjes së afateve të pjesëmarrjes në misione ushtarake, për të cilat kërkohet një CSP e vlefshme.

2. Për çdo rast të referuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, duhet që:

a) individi, për të cilin kërkohet lëshimi i CSP-së në kushtet e përcaktimeve të këtij neni, të mos i jetë hequr apo refuzuar pajisja me CSP gjatë 10 (dhjetë) viteve të fundit;

b) titullari i institucionit, në kërkesën e tij për AKSIK-në, të sqarojë rrethanat e urgjencës së jashtëzakonshme dhe të pamundësisë për të paraqitur kërkesë, sipas procedurave normale për pajisjen me CSP të individit, si dhe të konfirmojë se “nuk ekzistojnë dyshime paraprake për mundësinë e rrezikut të papranueshëm të sigurisë”.

Kërkesa shoqërohet me dokumentet e nevojshme për t’u pajisur me CSP, sipas nenit 8, të kësaj rregulloreje.

3. Përpara lëshimit të CSP-së në kushtet e rrethanave të urgjencës së jashtëzakonshme, individi i nënshtrohet brifimit të sigurisë dhe nënshkruan për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësive të tij individuale për shkeljet e sigurisë.

4. Në çdo rast, lëshimi i CSP-së në kushtet e rrethanave të urgjencës së jashtëzakonshme kryhet pasi plotësohen kushtet e parashikuara në pikat 1, 2 e 3, të këtij neni.

5. Lëshimi i CSP-së në kushtet e rrethanave të urgjencës së jashtëzakonshme për një individ kryhet jo më shumë se një herë në 5 (pesë) vjet.

6. CSP-ja e lëshuar në kushtet e rrethanave të urgjencës së jashtëzakonshme, përjashtohet nga zgjatja e afatit të vlefshmërisë së saj, referuar nenit 31, të kësaj rregulloreje.

Neni 31

Zgjatja e afatit të vlefshmërisë së CSP-së në rrethanat e urgjencës së jashtëzakonshme

1. Në kushtet e rrethanave të urgjencës së jashtëzakonshme, AKSIK-u ka të drejtë të bëjë zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së një CSP-je vetëm një herë gjatë ciklit të vlefshmërisë së saj dhe jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike, në rastet kur:

a) AKSIK-ut i adresohet një kërkesë zyrtare e arsyetuar për zgjatjen e afatit të CSP-së në rrethanat e urgjencës së jashtëzakonshme dhe rrethanat e pamundësisë për të paraqitur kërkesë, sipas procedurave normale për ripajisjen e individit me CSP të re;

b) individi, për të cilin kërkohet zgjatja e afatit, zotëron një CSP të vlefshme.

Përjashtohet zgjatja e afatit të vlefshmërisë së CSP-ve të lëshuara, në zbatim të kritereve të parashikuara në nenin 30, të kësaj rregulloreje.

2. Kërkesa për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së CSP-së në rrethanat e urgjencës së jashtëzakonshme mund të aplikohet për kategoritë e individëve, që janë të pajisur me një CSP të vlefshme, të cilën e kanë përfituar, referuar mënyrave të paraqitjes së kërkesës së parashikuar në nenin 7, të kësaj rregulloreje.

Për personelin e një operatori ekonomik të interesuar, zgjatja e afatit të vlefshmërisë së CSP-së në rrethanat e urgjencës së jashtëzakonshme aplikohet vetëm kur individi është i përfshirë në një

marrëdhënie kontraktuale, në kushtet e zbatimit të një projekti, programi, kontrate dhe nënkontrate në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar.

KREU IV EDUKIMI DHE VETËDIJËSIMI I SIGURISË

Neni 32

Rrethi i individëve që i nënshtrohet brifimit të sigurisë

1. Çdo individ, i cili ka akses tek informacioni i klasifikuar “i kufizuar” e më lart i nënshtrohet brifimit të sigurisë.

2. Në raste të veçanta, brifimit të sigurisë i nënshtrohen edhe individë të tjerë, që, për shkak të detyrës që kryejnë, kanë akses tek informacione të paklasifikuara, të cilat mund të jenë me vlerë për inteligjencën e vendeve jomike ose në mënyrë të paqëllimshme mund të marrin dijeni për përmbajtjen e informacionit të klasifikuar në mjedisin e punës.

Neni 33

Tipet e brifimit të sigurisë

1. Rrethi i individëve i parashikuar në nenin 32, të kësaj rregulloreje, i nënshtrohet brifimit të sigurisë: fillestar, periodik, specifik dhe përfundimtar, ose debrifimit.

2. Brifimi fillestar i sigurisë kryhet në çdo rast përpara se individ i të fillojë kryerjen e një detyre në pozicionin e ri të punës.

Individi i pajisur me CSP të përshtatshme lejohet që të ketë akses tek informacioni i klasifikuar vetëm pasi më parë i është nënshtruar brifimit fillestar të sigurisë.

3. Brifimi periodik i sigurisë kryhet jo më pak se një herë në vit për të gjithë individët, që kanë akses tek informacioni i klasifikuar “i kufizuar” e më lart.

Këtij brifimi i nënshtrohen edhe individë të tjerë, që, për shkak të detyrës që kryejnë, kanë akses tek informacione të paklasifikuara, të cilat mund të jenë me vlerë për inteligjencën e vendeve jomike ose në mënyrë të paqëllimshme mund të marrin dijeni për përmbajtjen e informacionit të klasifikuar në mjedisin e punës.

4. Brifimi specifik i sigurisë aplikohet ndaj individëve, që kanë akses tek informacioni i klasifikuar “i kufizuar” e më lart dhe udhëtojnë apo ngarkohen për të kryer detyra institucionale në vendet ku mund të ekzistojë një rrezik i veçantë sigurie.

Ky brifim sigurie përfshin:

a) informacion të përgjithshëm me natyrë politike, ekonomike e sociale rreth vendit apo vendeve, ku mund të udhëtohet apo do të kryhen detyrat dhe që paraqitet rrezik sigurie i veçantë;

b) informacion dhe udhëzime për natyrën dhe kërcënimin e inteligjencës jomike, taktikat e përdorura prej tyre dhe masat mbrojtëse për të minimizuar ndjeshmërinë ndaj këtyre kërcënimeve;

c) udhëzime për të raportuar kontaktet e dyshimta tek autoritetet e sigurisë menjëherë pas përfundimit të udhëtimit apo të detyrës së ngarkuar nga institucioni.

5. Brifimi përfundimtar i sigurisë ose debrifimi aplikohet për çdo individ, i cili nuk ka më nevojë për akses tek informacioni i klasifikuar, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, transferimeve apo përfundimit të kontratës apo programit/projektit, që përmban informacion të klasifikuar.

6. Brifimi përfundimtar i sigurisë ose debrifimi konsiston në riinformimin për përgjegjësitë individuale të vazhdueshme për të mbrojtur informacionin e klasifikuar edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, transferimit apo përfundimit të kontratës, projektit/programit, që përmban informacion të klasifikuar.

7. Çdo individ, që i nënshtrohet brifimit përfundimtar të sigurisë ose debrifimit, nënshkruan dokumentin përkatës.

8. Dokumenti përkatës i brifimit përfundimtar të sigurisë ose debrifimit përmban, por nuk kufizohet vetëm në:

a) vetëdijen dhe përgjegjësitë për pasojat ligjore të individit për të mos përhapur informacionin e klasifikuar, të cilin e ka mësuar gjatë ushtrimit të detyrës apo zbatimit të kontratës, projektit/programit, që përmbante informacion të klasifikuar;

b) konfirmimin me përgjegjësi se individit ka dorëzuar dhe nuk ka mbajtur asnjë informacion të klasifikuar apo kopje të tij pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, transferimit apo përfundimit të kontratës, projektit/programit, që përmban informacion të klasifikuar;

c) konfirmimin se do të raportojë në vijimësi çdo përpjekje apo tentativë të adresuar ndaj tij, me qëllim për t'u njohur në mënyrë të paligjshme me përmbajtjen e informacionit të klasifikuar dhe kujdesin nga intelijenca e vendeve jomike gjatë udhëtimeve në vende me rrezik sigurie të veçantë.

Neni 34

Struktura përgjegjëse dhe mbajtja e rekordeve të sigurisë

1. Oficeri i sigurisë apo struktura e sigurisë e një institucioni, si dhe oficeri i sigurisë industriale e zëvendësi i tij tek operatori ekonomik i interesuar janë përgjegjës për kryerjen e brifimit të sigurisë: fillestar, periodik, specifik dhe përfundimtar ose debrifimit për të gjithë rrethin e individëve të parashikuar në nenet 32 e 33, të kësaj rregulloreje.

2. Struktura përgjegjëse, sipas parashikimit të pikës 1, të këtij neni, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe specifikave përkatëse, ka për detyrë:

a) të planëzojë tipin e brifimit të sigurisë, që do të aplikojë rast pas rasti për çdo individ;

b) të mbajë të gjitha rekordet lidhur me detajet e brifimeve të kryera dhe rastet kur një individ refuzon që t'u nënshtrohet brifimeve të sigurisë.

3. Çdo individ, që i nënshtrohet brifimit të sigurisë, nënshkruan në dokumentin përkatës përpara strukturës përgjegjëse, sipas parashikimit të pikës 1, të këtij neni.

4. AKSIK-u harton modelet orientuese për tipat e brifimeve të sigurisë, që aplikohen nga struktura përgjegjëse dhe mban rekordet në nivel kombëtar.

Neni 35

Trajnimet

1. AKSIK-u kryen trajnime periodike të programuara për aspektet e sigurisë së personelit.

2. Me kërkesë të institucioneve shtetërore apo të operatorëve ekonomikë të interesuar, AKSIK-u mund të kryejë edhe trajnime për çështje të veçanta lidhur me aspektet e sigurisë së personelit, përtej parashikimeve në programin fillestar të trajnimeve.

3. AKSIK-u mban të gjitha rekordet lidhur me individët e trajnuar, referuar institucioneve shtetërore përkatëse apo operatorëve ekonomikë të interesuar.

KREU V

MBIKËQYRJA E MASAVE TË SIGURISË SË PERSONELIT

Neni 36

Mbikëqyrja e masave të sigurisë

1. Autoritetet verifikuese dhe çdo strukturë shtetërore, që merr pjesë në procesin e verifikimit të sigurisë së një individit, i nënshtrohen mbikëqyrjes së masave të sigurisë nëpërmjet inspektimeve periodike apo rastësore, në lidhje me zbatueshmërinë e masave të sigurisë së personelit, që burojnë nga dispozitat për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

2. AKSIK-u informohet dhe mbikëqyr procedurën e verifikimit të sigurisë të aplikuar nga autoritetet verifikuese dhe çdo strukturë tjetër shtetërore e përfshirë në këtë proces.

Neni 37
Inspektimet

1. AKSIK-u kryen inspektime periodike tek autoritetet verifikuese dhe strukturat e tjera shtetërore, lidhur me zbatimin e standardeve të sigurisë së personelit, të parashikuara në këtë rregullore dhe në aktet normative të nxjerra nga titullarët e autoriteteve verifikuese e të strukturave të tjera shtetërore.

2. Procedura administrative e inspektimit fillon pasi më parë është bërë lëshimi i autorizimit të inspektimit nga drejtori i përgjithshëm i AKSIK-ut.

3. Autorizimi për inspektim përmban:

- a) të dhënat identifikuese të institucionit, që lëshon autorizimin;
- b) objektin e inspektimit;
- c) bazën ligjore;
- ç) datën dhe vendin e lëshimit të autorizimit për inspektim;
- d) të dhëna për identitetin e punonjësve të autorizuar për të kryer inspektimin;
- dh) të dhëna për identitetin e personave të tjerë të autorizuar për kryerjen e veprimeve ndihmëse, kur është e nevojshme;
- e) të dhëna lidhur me emërtimin e institucionit, të strukturave apo të vendeve, që do të inspektohen, apo të dhëna për përcaktimin sa më të saktë të veprimtarisë konkrete që do t'i nënshtrohet inspektimit;

ë) kohëzgjatjen në ditë pune të inspektimit, duke shënuar ditën e fillimit e të përfundimit të tij;

f) të dhënat e identifikimit, pozicioni dhe nënshkrimi i personit, që ka autorizuar inspektimin.

4. Përcaktimi i kohëzgjatjes së inspektimit bëhet duke mbajtur në konsideratë specifikat e strukturave apo të vendeve që do të inspektohen, kompleksitetin e veprimtarisë institucionale dhe natyrën inspektimit.

5. Inspektimi kryhet vetëm nga punonjësit e autorizuar për inspektim, të cilët, në çdo rast, duhet të identifikohen nëpërmjet dokumentit identifikues të funksionit, nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm i AKSIK-ut.

6. Me përjashtim të rasteve të veçanta, autorizimi për inspektim i dërgohet titullarit të autoritetit verifikues apo strukturës shtetërore, që është parashikuar të inspektohet, jo më vonë se 3 (tri) ditë kalendarike përpara datës së fillimit të inspektimit.

7. Autoriteti verifikues apo struktura shtetërore, që do të inspektohet, nëpërmjet titullarit, ka të drejtë që, brenda afatit të parashikuar, të parashtojë kërkesa të veçanta te drejtori i përgjithshëm i AKSIK-ut, lidhur me programin e inspektimit. Zgjidhja e këtyre kërkesave bëhet në mirëkuptim ndërmjet dy titullarëve, bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

Neni 38
Raporti i inspektimit dhe masat korrigjuese

1. Pas inspektimeve të kryera, AKSIK-u i adreson titullarit të autoritetit verifikues apo të strukturës shtetërore të inspektuar raportin paraprak, me rekomandimet e masave dhe afatin e fundit për korrigjimin e parregullsive dhe të shkeljeve të konstatuara.

2. Titullari i autoritetit verifikues apo i strukturës shtetërore të inspektuar, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga dita e marrjes së raportit paraprak të inspektimit të AKSIK-ut, ka detyrimin t'i njohë strukturat e individët e inspektuar me detajet e raportit paraprak të inspektimit.

3. Titullari i autoritetit verifikues apo i strukturës shtetërore të inspektuar ka të drejtë të paraqesë në AKSIK kërkesë me shkrim, lidhur me rishikimin e elementeve të paraqitura në raportin paraprak të inspektimit.

4. AKSIK-u, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës për rishikimin e elementeve të raportit paraprak të inspektimit, bën shqyrtimet përkatëse dhe i adreson raportin përfundimtar titullarit të autoritetit verifikues apo të strukturës shtetërore të inspektuar

me rekomandimet e masave dhe afatin e fundit për korigjimin e parregullsive dhe të shkeljeve të konstatuara.

5. Mospërmbushja e masave të rekomanduara dhe e afateve të lëna për korigjimin e parregullsive dhe të shkeljeve të sigurisë të konstatuara nga raporti përfundimtar i inspektimit të AKSIK-ut përbën shkak të mjaftueshëm për aplikimin e masave ndëshkuese për personat përgjegjës, referuar legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar dhe inspektimet.

KREU VI SHKELJET E SIGURISË DHE MASAT NDËSHKUESE

Neni 39

Konstatimi i shkeljeve të sigurisë së personelit dhe masat ndëshkuese

1. Oficeri i sigurisë/struktura e sigurisë e institucionit shtetëror apo e operatorit ekonomik të interesuar, nëpërmjet titullarit, njofton menjëherë me shkrim AKSIK-në, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, për të gjitha rastet kur një individ kryen shkelje të sigurisë në të gjitha disiplinat e informacionit të klasifikuar, duke specifikuar:

- a) të dhënat për individin që ka kryer shkeljen e sigurisë;
- b) rrethanat dhe llojin e shkeljes së sigurisë;
- c) pasojat e ardhura dhe ato të mundshme nga shkelja e sigurisë;
- ç) nëse janë marrë masa me karakter administrativ, disiplinor apo penal për individin përgjegjës;
- d) propozime për masa të mëtejshme.

2. Individualizimi i shkeljeve të sigurisë dhe i masave ndëshkuese për shkelje sigurie në të gjitha disiplinat e informacionit të klasifikuar përdoret nga AKSIK-u në vlerësimin e sigurisë për individët, që mbajnë ose paraqesin kërkesë për t'u pajisur me CSP.

KREU VII DISPOZITA TË VEÇANTA DHE TË FUNDIT

Neni 40

Baza qendrore e të dhënave

1. AKSIK-u administron e përditëson sistemin qendror të të dhënave për të gjithë individët, ndaj të cilëve:

- a) është lëshuar, refuzuar, pezulluar përkohësisht, ndërprerë procedura apo u është hequr CSP-ja;
- b) janë aplikuar masa ndëshkuese për shkelje sigurie në të gjitha disiplinat e informacionit të klasifikuar, referuar legjislacionit në fuqi;
- c) është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës apo janë transferuar, duke qenë të pajisur me CSP të vlefshme;
- ç) janë marrë masa dhe është kryer brifimi/debrifimi i tyre.

2. Oficeri i sigurisë/struktura e sigurisë e institucionit shtetëror apo e operatorit ekonomik të interesuar administron e përditëson regjistrin fizik dhe elektronik me të gjitha të dhënat e parashikuara në shkronjat: “a”, “b”, “c”, dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni, lidhur me punonjësit dhe stafet e tyre.

3. Një herë në vit, oficeri i sigurisë/struktura e sigurisë e institucionit shtetëror apo e operatorit ekonomik të interesuar, kryen rakordimet me AKSIK-në, lidhur me të gjitha të dhënat për punonjësit dhe stafet e tyre, sipas parashikimeve në shkronjat: “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni.

Neni 41

Dispozita të fundit

1. Ministritë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë të interesuar marrin masa për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

2. Ngarkohet AKSIK-u për mbikëqyrjen dhe kontrollin e ministrive, të institucioneve shtetërore dhe të operatorëve ekonomikë të interesuar, lidhur me zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.